



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 116/1 Prot

Tiranë, më 07.02.2020

V E N D I M

Nr.10, datë 07.02.2020

“Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë së aktit nr. 3402 prot., datë 08.11.2019 të Kryetarit të Bashkisë Tropojë, për dhënie mase disiplinore ndaj nëpunësit ** dhe masat për përmirësimin e gjendjes”***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të verifikimit të informacionit të marrë nga kërkesa e nëpunësit *****,

Vërej se:

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është paraqitur një kërkesë e regjistruar me nr. 1583 prot., datë 11.11.2019, nga nëpunësi ***** në të cilën janë parashtruar pretendimet e tij për paligjshmëri në kryerjen e ecurisë disiplinore dhe dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”, me aktin nr. 3402 prot., datë 08.11.2019 të Kryetarit të Bashkisë Tropojë.

Nga tërësia e dokumentacionit të administruar, konstatohet se punonjësi ***** është nëpunës civil dhe mban pozicionin “Drejtor në Drejtorinë Ekonomike”, në Bashkinë Tropojë, prandaj shqyrtimi i kërkesës për verifikimin e ligjshmërisë së kësaj procedure

disiplinore përfshihet në juridiksionin dhe kompetencën e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit që pasqyron veprimet administrative që janë kryer gjatë kësaj ecurie disiplinore, rezultoi sa më poshtë:

Kryetari i Bashkisë Tropojë, me shkresën nr. 3287 prot, datë 01.11.2019 “*Informacion*”, drejtuar Drejtorisë Ekonomike dhe Drejtorisë së Shërbimeve (*Sektorit Juridik, Sektorit të Tatim Taksave*) ka kërkuar informacion të detajuar për gjendjen ekonomike, dokumentare dhe atë faktike të institucionit, i cili duhej të paraqitej deri **në datën 05.11.2019**.

Duke qenë se brenda datës 05.11.2019 (*Sipas parashtrimit të Kryetarit të Bashkisë, në përgjigjen dërguar Komisionerit*), nga ana e nëpunësit ***** i cili mban pozicionin Drejtor i Drejtorisë Ekonomike, nuk është dhënë informacioni i kërkuar, është vijuar me dhënien prej tij, në cilësinë e prorit direkt, të masës disiplinore “*Vërejtje*”.

Në lidhje me parashtrimin e mësipërm, kërkuesi ka sqaruar se është njohur me kërkesën për informacion dhe më pas ka përgatitur informacionin përkatës, të cilin e ka dorëzuar në protokollin e Bashkisë Tropojë, pikërisht në datën 05.11.2019, me shkresën nr. 3287/3 prot., datë 05.11.2019 “*Kthim përgjigje*”, (*akte të materializuar në kërkesën e tij*) pra brenda afatit të përcaktuar, siç kërkon pika 1, germa “a”, e nenit 57, ligjit nr. 44/2015. “*Kodi i Procedurave Administrative*”.

Vonesat në dorëzimin e informacionit të mësipërm tek drejtuesi i institucionit, nga hallkat e tjera administrative (*protokolli, sekretaria, etj.*) nuk mund të shërbejnë si shkak për penalizimin e nëpunësit në fjalë dhe kjo duhej të mbahej parasysh nga ana e eprorit që ka zhvilluar ecurinë disiplinore.

Mirëpo, sqarimi i situatës si më sipër nuk është arritur pasi eprori direkt, Kryetari i Bashkisë Tropojë, nuk ka respektuar procedurën e kryerjes së një ecurie disiplinore, e cila si rregull duhej të përmbante, aktin për fillimin e ecurisë disiplinore, njoftimin për këtë ecuri të nëpunësit që penalizohet, zhvillimin e takimit për dëgjimin e pretendimeve të nëpunësit, marrjen e provave të parashtruara ose pretenduara dhe në fund marrjen e masës disiplinore, ashtu siç përcaktohen në nenin 59, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, dhe Vendimin nr. 115, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil*”, të ndryshuar, si dhe të Udhëzimit nr. 1, datë

2.4.2014, të Departamentit të Administratës Publike, “Për elementët kryesorë proceduralë dhe materialë të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”.

Konkretisht, bazuar në pikën 9, të vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, ndryshuar me vendimin nr. 437 dt. 18.07.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil”, eprori direkt, pasi konstaton se në veprimet e vartësit ekzistojnë elemente të thyerjes së disiplinës, bën klasifikimin e shkeljes sipas renditjes së pikës 1, të nenit 57, të ligjit nr. 152/2013.

Sipas pikës 10, të aktit të mësipërm në rast se shkelja do të klasifikohet në shkeljet e lehta, eprori direkt fillon ecurinë disiplinore, dhe referuar pikës 13, të po këtij akti, njofton me shkrim nëpunësin përkatës:

- a) për shkeljen disiplinore të pretenduar për të;
- b) për të drejtën që ai ka për të paraqitur, me shkrim, sqarimet e tij rreth shkeljes së pretenduar dhe afatin deri kur duhet të paraqitet ky sqarim;
- c) për të drejtën që ka për të inspektuar dosjen e procedimit, për t’u dëgjuar, ai vetë apo me përfaqësues ligjor, për të paraqitur dëshmitarë, për të paraqitur prova ose për të kërkuar marrjen e tyre;
- ç) për datën kur do të shqyrtohet shkelja e pretenduar. Kjo datë nuk mund të caktohet më shpejt se 4 (katër) ditë dhe jo më vonë se 16 (gjashtëmbëdhjetë) ditë nga marrja e njoftimit nga nëpunësi.

Vetëm pasi të ishte respektuar faza e mësipërme e procedurës disiplinore, në zbatim të pikës 17, të vendimit në fjalë, ku parashikohet se: “Organi disiplinor, pasi shqyrton çështjen sipas pikave 13, 14 dhe 15, të këtij vendimi, dhe pasi ka dëgjuar nëpunësin përkatës ose përfaqësuesin e tij ligjor, apo vë në dukje, me shkrim, mosparaqitjen e tij, megjithëse nëpunësi ka marrë dijeni rregullisht...” mund të vendoset marrja e masës disiplinore ose ndërprerja e ecurisë disiplinore.

Respektimi i procedurës së përcaktuar nuk është një formalitet i panevojshëm, pasi shëmbulli i veprimit të mësipërm tregon që, nëse do të ishte respektuar radha e veprimeve administrative, do të ishte evidentuar fakti që materiali i kërkuar ishte dorëzuar brenda afatit dhe se në këtë rast nuk kishte vend të fillonte ecuria disiplinore, apo nëse kishte filluar, të vendoset ndërprerja e saj.

Mosrespektimi i procedurës nga ana e organit disiplinor, në kuptim të nenit 108, pika a/ii) të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH” përbën shkak për

pavlefshmëri absolute të aktit administrativ nr. 3402 prot., datë 08.11.2019 të Kryetarit të Bashkisë Tropojë, për dhënien e masës disiplinore “*vërejtje*” ndaj nëpunësit *****.

Bazuar në nenin 110, pika 1, të ligjit në fjalë, ky akt është nul dhe nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar ose jo si i tillë. Në bazë të pikës 2, të po kësaj dispozite, pavlefshmëria absolute e aktit mund të konstatohet në çdo kohë nga organi publik që e ka nxjerrë atë, etj., dhe bazuar në nenin 111, pika 1, të atij ligji, organi publik (*në këtë rast Kryetari i Bashkisë Tropojë*), duhet të konstatojë pavlefshmërinë absolute të tij, nëpërmjet një akti të ri me shkrim.

Në këtë moment është me vend të theksohet që, pavarësisht pavlefshmërisë absolute të procedurës së mësipërme administrative, nëse edhe pas rishqyrtimit të provave dhe dokumentacionit, krijohet bindja se në veprimet e këtij ose atij nëpunësi ka elementë të thyerjes së disiplinës, nuk ka asnjë pengesë që ecuria të fillojë përsëri nga e para, gjithmonë duke respektuar kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil në zhvillimin e procedimit disiplinor.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; bazuar në nenet 108, 110, 111 e 113 të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, si dhe në nenet 16, 34 dhe 35, të Rregullores, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të kërkoj nga ana e organit publik, Kryetari i Bashkisë Tropojë, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit nr. 3402 prot., datë 08.11.2019, për dhënien e masës disiplinore “*vërejtje*” ndaj nëpunësit *****.
2. Njësia e Burimeve Njerëzore e Bashkisë Tropojë, të krijojë të gjitha kushtet e të ndjekë ecurinë e procesit administrativ, për zbatimin e detyrës së mësipërme.
3. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 15 ditë, nga marrja dijeni për këtë vendim.

4. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse është e detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
5. Në rast të mos respektimit të këtij vendimi, përgjegjësia do të jetë personale e subjekteve, që nuk kanë kryer detyrimet e lëna në këtë vendim dhe në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
6. Të njoftohet për këtë vendim Bashkia Tropojë dhe nëpunësi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha